



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), alinea 22 dhe neni 20 paragrafi (1) alinea 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-369 datë 19.12.2022 dhe Propozimin PA1 nr.08-369 datë 4.1.2023 nga dr.Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me Konkluzionin, me nr.ark.02-39/11 datë 10.1.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 1-rë mbajtur më 9.1.2023 miratoi:

Aktvendim
për ndërprerje të procedurës së ngritur për marrje
të lejes për transmetim në televizion

NDALET procedura e ngritur për marrjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizion IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015, me Propozim PA1 nr.08-369 datë 19.12.2022.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 45-të mbajtur më 21.12.2022, dhe Konkluzionin me nr.ark.02-4661/7 datë 22.12.2022, miratoi Propozimin PA1 nr.08-369 datë 19.12.2022, për ngritjen e procedurës për marrje të lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) televizion IRIS SHPK Shtip, dorëzuar nga propozuesi, dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për inicim të procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR televizion IRIS SHPK Shtip, me nr.08-902 datë 8.7.2015, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së jashtëzakonshme, sipas detyrës zyrtare, mbikëqyrje administrative, në Raportin me nr.ark.03-4556/1 datë 12.12.2022, u konstatua se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kuadrovice, përcaktuar në Rregulloren për kushtet teknike minimale, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për dhënien e lejes për transmetim në radio dhe televizion (Tekst i pastruar) me nr. ark.01-3747/1 datë 6.10.2022.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia më datë 22.12.2022, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 me nr.08-369 datë 22.12.2022, me të cilën është njoftuar se nëse nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm nga i cili të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kuadrovice, përcaktuar në Rregulloren e lartpërmendur, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për marrjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Njoftimin PA1 nr.08-369 datë 22.12.2022, i është dërguar SHTR televizion IRIS SHPK Shtip, me shkrim. Duke pasur parasysh se drejtuar Agjencisë deri në momentin e miratimit të këtij Aktvendimi, nuk i është dorëzuar përgjigje nga A.D Posta e RMV-së për pranimin e Njoftimit (PA1 nr.08-369 datë 22.12.2022.), Agjencia ka kryer kontroll në sistemin elektronik – përcjellja e dërgesave të A.D

¹ Alinetë 8 dhe 9 janë fshirë, shiko: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

PA1 Nr.08-369
Shkup 10.01.2023.



Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe
Audiovizuele

rr. Makedonija nr.38
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut

Tel. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
kontakt@avmu.mk





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ

Postës së RMV-së nëpërmjet së cilës kontrollohet statusi i dërguesit, gjatë së cilës u konstatua se njoftimi i cituar i është dotëzuar transmetuesit më 28.12.2022.

Më 3.1.2023, drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit, është dorëzuar Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ me nr.ark.03-28/1 datë 3.1.2023, nga ku u konstatua se SHTR television IRIS SHPK Shtip i plotëson kushtet minimale kuadrovike, përcaktuar në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për dhënien e lejes për transmetim në radio dhe television, pas së cilës nga ana e drejtorit drejtuar Këshillit të Agjencisë është dorëzuar Propozim me nr.ark. 08-369 datë 4.1.2023, për miratimin e aktvendimit për ndërprerjen e procedurës së ngritur (inicuar) për marrje të lejes për transmetim televiziv të SHTR television IRIS SHPK Shtip, nr.08-902 datë 8.7.2015.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), alinea 22 dhe neni 20, paragrafi (1), alinea 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenin 104, paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-369 datë 19.12.2022 dhe Propozimin PA1 nr.08-369 datë 4.1.2023, nga dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin me nr.ark.02-39/11 datë 10.1.2023, Këshilli i Agjencisë në seancën e 1-rë mbajtur më 9.1.2023, vendosi të ndërpresë procedurën e ngritur (inicuar) për marrjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

Dorëzuar deri tek:

- SHTR television IRIS SHPK Shtip;
- Drejtuesit të SHTR television IRIS SHPK Shtip;
- Njësisë për mbështetje informative dhe punë të përgjithëshme – arkivi;
- Sektori për çështje juridike;
- Sektori për financa dhe logjistikë; dhe
- Personat e emëruar në Agjenci për mbajtjen e regjistrit PA1.